

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Narrativat para vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/narrativat-para-vendimit-te-hages-per-ish-kreret-e-uck-s-e/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:52:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:47:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fb2f97d5d6a486575ea16cf61cf339048efcd36be3a64d0f9bbf103238678d8b
TEKSTI	c5e46437ac9a083d5ef1684864c6411680bfd78e94ec788efe250531ab2816c3
PAMJA	3363e4de8a95db9b3a4bbe37e1ebb27490569692ced33b82c87adf24aa177d1a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	13604ca18445c3833b6b1903c5b9c9ca2224e0a90c0eaa39aedf6c3007d26c03
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcf62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/13604ca18445c3833b6b1903c5b9c9ca2224e0a90c0eaa39aedf6c3007d26c03>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > BOTA

Narrativat para vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së

19:47 : 15/09/2026 në BOTA, KRYESORE, RAJONI

Nga Jona Cenameri – **Faktoje.al**

Në prag të vendimit të Hagës për Hashim Thačin dhe tre ish-krerët e tjerë të UÇK-së, pasiguria për atë që do të ndodhë më 16 shtator ndihet edhe në titujt e lajmeve. “Trazira”, “protestë”, “tensione”, “dhunë”, “kaos” dhe skenarë për përplasje nisën të shfaqeshin në raportimet për atë që mund të pasonte vendimin e Hagës. Fillimisht, vëmendja u përqendrua te deklaratat e Aleksandar Vuçiçit mbi rezultatin e gjyqit.

Më pas diskutimi nuk mbeti vetëm te pyetja nëse Thaçi do të dënohej apo lirohej. Në tituj dhe debate publike nisi të shfaqej gjithnjë e më shumë një pyetje tjetër: çfarë do të ndodhte në Kosovë pas vendimit?

Çfarë pritet të ndodhë më 16 shtator?

Më 16 shtator, në orën 10:00, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do të shpallin aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Lexo edhe:

[Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?](#)[‘Ballkani është fuçi baruti’/ Kongresmeni amerikan apel Hagës: Drejtësia të mos ndikohet nga politika](#)

Të katërt akuzohen për krime kundër njerëzimit (6 kategori veprash penale) dhe për krime lufte (4 kategori veprash penale). Gjykimi nisi më 3 prill 2023, ndërsa faza e paraqitjes së provave u mbyll më 18 dhjetor 2025.

Procesi

Procesi nuk është një gjyq ndaj UÇK-së si organizatë. Sipas Dhomave të Specializuara, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi akuzohen mbi bazën e përgjegjësisë penale individuale për veprat që u atribuohen në aktakuzë.

Aktakuza pretendon se krimet janë kryer nga anëtarë të UÇK-së, por përgjegjësia penale që

TË GJITHA

**Narrativat para vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së**

19:47 : 15/09/2026

**“Me ç’fytirë pushtetit i ngjitesh?”/ Protestuesit ironizojnë Ramën me pankarta në ditën e 108-të**

19:32 : 15/09/2026

**“Arrestoni Ramën”/ Protesuesit marshojnë drejt Kryeministrit**

19:18 : 15/09/2026

**Kancelari gjerman njofton masa lehtësuese për çmimet e larta të karburanti**

19:13 : 15/09/2026

**5 interpelanca urgjente/ Ç’pritet të ndodhë të enjten në Kuvend, zbardhet rendi i ditës**

19:05 : 15/09/2026

**Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?**

18:52 : 15/09/2026

**“Dita 5”/ Bardhi: SPAK po hesht për rëndimin e masës ndaj Ballukut, pse po i jep kohë Ramës?**

18:41 : 15/09/2026

shqyrton gjykata në këtë çështje u atribuohet individualisht katër të akuzuarve.

Sipas Dhomave të Specializuara, gjatë procesit dhanë dëshmi në sallën e gjyqit 134 dëshmitarë: 125 të thirrur nga Prokuroria, 2 nga Mbrojtja e Viktimave dhe 7 nga ekipet e Mbrojtjes.

Deklaratat përmbyllëse u mbajtën nga 9 deri më 18 shkurt 2026. Të katër të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm ndaj akuzave.

Debati Publik

Në debatin publik është krijuar përshtypja se më 16 shtator vendoset automatikisht edhe nëse Hashim Thaçi del nga paraburgimi. Situata e tij juridike është më komplekse.

Thaçi është i përfshirë edhe në një proces të dytë, së bashku me Bashkim Smakajn, Isni Kilajn, Fadil Fazliun dhe Hajredin Kuçin, për vepra që lidhen me administrimin (pengimin) e drejtësisë.

Argumentet përfundimtare në atë çështje u zhvilluan më 10, 11 dhe 14 shtator.

Prokuroria kërkoi gjashtë vjet burg për Thaçin dhe që një dënim të ekzekutohej pas çdo dënimi që mund të marrë në procesin kryesor. Mbrojtja kërkoi pafajësi.

Nga “do të digjet Shqiptaria” te frika për trazira

Një nga deklaratat që i parapriu narrativës së ditëve të fundit erdhi më 20 gusht.

Ish-nënkryetari i OVL-UÇK-së Nasim Haradinaj deklaroi se, në rast të një aktgjykimi dënues, situata mund të “eskalojë shumë keq”.

“Jo Kosova, por krejt Shqiptaria ka me u kallë flakë”, tha ai duke përmendur Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ai shtoi se gjyqtarët “nuk mund të marrin vendime të cilat e trazojnë një vend”.

Vetë deklarata ishte e fortë dhe ngriti shqetësime për mënyrën se si mund të interpretohej.

Deklarata e Nasim Haradinajt

Megjithatë, brenda pak ditësh diskutimi filloi të zhvendosej nga mundësia e protestave apo trazirave te pretendimi se një dënim i ish-krerëve të UÇK-së mund të sillte dhunë kundër serbëve.

Më 25 gusht, kryetari i Komisionit parlamentar serb për Mbrojtjen dhe Punët e Brendshme, Milovan Drecun, deklaroi se një zemërim i akumuluar nëse krerët e UÇK-së dënohen mund të drejtohej ndaj serbëve, veçanërisht në veri të Kosovës.

Tabloidi serb Alo e përktheu këtë frikë në titullin sensacionalist: “Shqiptarët paralajmërojnë të keqen dhe kërcënojnë: Kosova do të digjet nëse Thaçi dënohet!”, duke përdorur edhe terminologji fyese ndaj shqiptarëve.

Vuçiç: “E di” se Thaçi do të lirohet

Më 28 gusht, presidenti serb Aleksandar Vuçiç shtoi një element tjetër në narrativë: pretendimin se kishte informacion paraprak mbi rezultatin e gjyqit.

Ai deklaroi se kishte informacione, se vendimi ndaj Thaçit do të ishte “kryesisht pozitiv” dhe se një pjesë e dënimit do të mbulohej nga koha që ai kishte kaluar tashmë në paraburgim.

Sipas tij, një vendim i tillë do të përdorej nga Perëndimi për t’u thënë serbëve se ata ishin “të vetmit fajtorë” për luftërat në ish-Jugosllavi dhe se “gjaku serb nuk është i rëndësishëm”.

Ai e vendosi çështjen Thaçi në të njëjtin diskutim me vdekjen në burg të Ratko Mladiçit.

Ratko Mladiç

Deklarata e Vuçiçit erdhi një ditë pas vdekjes në Hagë të Ratko Mladiçit, ish-komandantit të Ushtrisë së Republikës serbe të Bosnjës, i dënuar me burgim të përjetshëm për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Vuçiçi i lidhi dy çështjet, duke e paraqitur trajtimin e Mladiçit dhe vendimin e pritshëm ndaj

1 naçit si pjese te se njejtës teze per standarde te dytësia te drejtësise ndërkombëtare ndaj serbëve. Ky paralelizëm u manifestua në ditët në vazhdim edhe në hapësirën mediatike serbe.

Miladiçi u varros më 7 shtator në Beograd, me nderime ushtarake si “hero” në një ceremoni me mijëra pjesëmarrës dhe zyrtarë serbë. Ceremonia shkaktoi reagime të forta në Bosnje dhe nga BE për glorifikimin e një personi të dënuar për krime lufte.

Nga “lirimi” te “po përgatitet dhunë”

Më 3 shtator, referuar “Marshimit për Liri” të paralajmëruar në Prishtinë, Vuçiç tha: “Po paralajmërojnë dhunë dhe po ushtrojnë presion ndaj gjykatës nëse (Thaçi dhe të tjerët) nuk lirohen”.

Presidenti serb tha se ishte “veçanërisht i shqetësuar” për marshimin dhe paralajmëroi se pas 16 shtatorit do të shpjegonte “çfarë kanë bërë kundër Serbisë njerëzit e bashkësisë ndërkombëtare” gjatë 5, 6 apo 7 viteve të fundit dhe “si e kanë zbatuar gjithë atë plan”.

Një media tjetër e çoi edhe më tej këtë linjë përmes publikimit: “Vuçiç i shqetësuar; ‘Shqiptarët po përgatisin marsh të madh’; ‘Po përgatitet dhunë’”.

Në tekst, pretendimi për një vendim që i jep lirinë Thaçit paraqitej si “kulmi i një plani të menduar thellë nga Perëndimi”.

Marshi i 12 shtatorit

Sipas versionit të Vuçiçit, strategjia kishte qenë që arrestimi i Thaçit të qetësonte Serbinë, ndërsa Albin Kurti të vinte në pushtet pa barrën e së kaluarës së luftës; më pas, ish-krerët e UÇK-së do të shpallehin të pafajshëm.

Por marshi i 12 shtatorit përfundoi pa incidentet që ishin përmendur në paralajmërimet e mëparshme. Paçka se marshimi sipas policisë së Kosovës përfundoi pa incidente, tabloide serbe folën për kaos.

Qeveria e Kosovës falënderoi pjesëmarrësit për “sjelljen paqësore” dhe “paraqitjen dinjitoze” dhe tha se bashkëpunimi me organet e rendit kishte kontribuar në mbarëvajtjen “e qetë dhe të sigurt” të aktivitetit.

Paralajmërimet

Ndërkohë me 14 shtator Lista Serbe kërkoi nga KFOR-i dhe EULEX-i të shtonin praninë në zonat me popullsi të përzier dhe veçanërisht në zonat serbe në jug të Ibrit.

Edhe nga veteranët e UÇK-së erdhi paralajmërimi për “revoltë qytetare”

Më 4 shtator, Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, deklaroi se veteranët nuk do të qëndronin “duarkryq” në rast të një vendimi dënues.

“Do të thërrasim protestë dhe situata mund të eskalojë. Mund të ketë demonstrata dhe revoltë qytetare”, deklaroi ai.

Mediat serbe: dhunë si në rast dënimi, ashtu edhe në rast pafajësie

Më 8 shtator, media serbe e kosovës, publikoi analizën “Frikë dhe dyshime në rajon para vendimit në Hagë: Çfarë vjen pas 16 shtatorit?”.

Në të argumentohej se protestat dhe incidentet nuk mund të përjashtoheshin. Analiza shkonte më tej, duke paraqitur edhe një skenar në të cilin dhuna ndaj serbëve mund të vazhdonte pavarësisht rezultatit: si “hakmarrje” në rast dënimi, ose për shkak të një ndjenje “triumfalizmi” në rast pafajësie.

Po atë ditë, Milovan Drecun deklaroi se nëse nuk kishte një “dënim të përshtatshëm” ndaj Thaçit dhe tre të tjerëve, kjo do të përbënte “falje dhe legalizim të krimeve të UÇK-së”.

Ndërsa drejtori i Zyrës serbe për Kosovën, Petar Petković, reagoi ndaj një murali në Prishtinë kushtuar Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit duke deklaruar se “politika e Prishtinës është që kriminelët ndaj serbëve të glorifikohen”.

Në mediat tabloide serbe si Kurir dhe Alo pati publikime provokuese. Kuris nën etiketën “e frikshme” shkruante: “Para shpalljes së vendimit për Hashim Thaçin, Prishtina intensifikon glorifikimin e UÇK-së”. Kurse Alo ju referohej krerëve të UÇK si “kasapë” në titullin:

Skanuat: Per kasapet e UÇK-se eshte bere nje murale ne mes te Prishtines:

Vuçiç ndryshon parashikimin

Më 12 shtator, vetëm katër ditë para aktgjykimit, Vuçiç dha një version tjetër.

Ai tha se gjatë qëndrimit në Paris dhe bisedave me liderë evropianë dhe botërorë kishte marrë “sinjale të ndryshme” dhe se tani ekzistonte mundësia që Thaçi të mernte një dënim të rëndë.

“Para 15 ditësh mora informacion se do të dënohej aq sa të mbulohej paraburgimi”, kujtoi ai, por shtoi se informacionet e reja ishin të ndryshme.

Çfarë thuhet në Kosovë?

Në Kosovë narrativa dominuese është e kundërt me atë serbe.

Në vend të tezës së një gjykate që do të favorizonte shqiptarët, një pjesë e konsiderueshme e diskursit politik e paraqiti procesin si padrejtësi ndaj UÇK-së dhe luftës çlirimtare të Kosovës.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, e cilësoi 16 shtatorin si një datë me rëndësi të krahaseshme me ditën e lirisë dhe të pavarësisë. Ai tha se në Hagë “po gjykohen ushtarët e UÇK-së, jo politikanët” dhe se lufta e UÇK-së kishte qenë “e pastër dhe e drejtë”.

Në “Marshin për Liri” më 12 shtator, Hamza iu drejtua edhe trupit gjykues: “Mendoni për pasojat para se të merrni vendimin”.

Në vazhdim të fjalimit ai e shpjegoi këtë me ndikimin që, sipas tij, një vendim i padrejtë do të kishte mbi familjet e dëshmorëve, veteranët dhe njerëzit e prekur nga lufta, ndërsa kërkoi pafajësinë e katër të akuzuarve.

Deklaratat politike

Deklarata e Hamzës mori një tjetër ngjyrim në mediat serbe. Tabloidi Alo e paraqiti atë si një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj gjyqtarëve të Hagës, me titullin ‘Shqiptarët kërcënojnë publikisht gjyqtarët e Hagës! Mendoni për pasojat!’.

Dy ditë më vonë, Alo shkruante ‘Prishtina kërcënon Hagën për shkak të UÇK-së gjakatare: “Mendoni për pasojat!”’, duke e shkëputur frazën nga shpjegimi që Hamza i kishte dhënë në vazhdim për pasojat politike dhe shoqërore që, sipas tij, do të kishte një vendim i padrejtë.”

Kurse Albin Kurti fillimisht mbajti një qëndrim të rezervuar. Më 8 shtator, i pyetur nëse kishte dijeni për vendimin, ai u përgjigj shkurt: “S’kam asnjë informacion”.

Por më 13 shtator, gjatë prezantimit të qeverisë së re në Kuvend, Kurti tha se “të gjithë jemi në ankth” për vendimin dhe e cilësoi kërkesën e Prokurorisë si “të padrejtë dhe të pabesueshme”, duke shtuar se “asnjë gjykatë vendore apo ndërkombëtare nuk mund ta njollojë UÇK-në”.

Në Shqipëri, kryeministri Edi Rama përdori gjuhë edhe më të drejtpërdrejtë. Më 12 shtator ai e quajti procesin “farsë” dhe shkroi: “Liri për çlirimtarët! Farsa është në ditët e fundit”, duke shprehur bindjen se Thaçi do të triumfohte me “forcën e së vërtetës së tij”.

Dy narrativa, një gjyq

Debati i javëve të fundit ka prodhuar dy narrativa.

Në Kosovë dhe Shqipëri, procesi është paraqitur shpesh si një gjykim që rrezikon të njollojë UÇK-në dhe historinë e luftës së Kosovës. Termat “çlirimtarë”, “luftë e pastër”, “farsë” dhe “rishkrim i historisë” janë bërë pjesë e kësaj kornize.

Në Serbi, gjyqi është futur në një kuadër tjetër: një sistem ndërkombëtar që, sipas Vuçiçit dhe zyrtarëve të tjerë serb, ka dënuar serbët dhe ka falur krimet e të tjerëve ndaj tyre.

Vendimi për lirimin e Thaçit është paraqitur si provë e këtij “standardi të dyfishtë”, kurse vendimi për dënimin e tij është shoqëruar me paralajmërime se mund të prodhojë zemërim dhe dhunë kundër serbëve.

Etiketa: [hage](#) [Hashim Thaçi](#) [uck](#)



Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?

18:52 : 15/09/2026



'Balkani është fuçi baruti'/ Kongresmeni amerikan apel Hagës: Drejtësia të mos ndikohet nga politika

15:58 : 15/09/2026



Avokatja e Thaçit: Kundërshtojmë të gjitha transkriptet, fajësia nuk mund të mbështetet në to

17:14 : 14/09/2026



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.